



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3681/ 8 prot.

Datë 07/01/2025

V E N D I M

Nr. 19/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07/01/2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “M.A.K Studio” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-23013-10-07-2024, me objekt “Supervizion punimesh Ndërtim aksi rrugor Elbasan - Paperr Faza II”, me fond limit 18,230,373.81 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre presje tetëdhjetë e një) leke pa TVSH ose 184,405.96 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesë presje nëntëdhjetë e gjashtë) euro pa TVSH, zhvilluar me datë 08.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: Operatori ekonomik “M.A.K Studio” SHPK me NIPT L014220170, me adresë: Njësia Bashkiake Nr. 7, Rruga “Muhedin Llagani”, Pallat 12- katësh (VALA), Kati 1, Nr. 7, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 08.10.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-23013-10-07-2024, me objekt “Supervizion punimesh Ndërtim aksi rrugor Elbasan - Paperr Faza II”, me fond limit 18,230,373.81 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre

presje tetëdhjetë e një) leke pa TVSH ose 184,405.96 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesë presje nëntëdhjetë e gjashtë) euro pa TVSH, zhvilluar me datë 08.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datë 08.11.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 03.12.2024, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave, si më poshtë vijon:

1	BOE"HYDROWATER-ALBANIA SHPK & "STUDIO-REBUS SHPK"	16,407,336.43	leke	285.00	pikë	Kualifikuar
2	"ERALD-G" SHPK	16,590,000.00	leke	282.00	pikë	Kualifikuar
3	"GJEOKONSULT & CO" SHPK	17,000,000.00	leke	282.00	pikë	Kualifikuar
4	"TOWER" SHPK	16,425,570.00	leke	282.00	pikë	Kualifikuar
5	"INFRATECH" SHPK	16,140,000.00	leke	280.50	pikë	Kualifikuar
6	BOE"SEED CONSULTING" SHPK & "DERBI-E" SHPK	16,580,000.00	leke	280.50	pikë	Kualifikuar
7	"A & E ENGINEERING" SHPK	17,300,000.00	leke	279.00	pikë	Kualifikuar
8	"TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING" SHPK	16,755,000.00	leke	279.00	pikë	Kualifikuar
9	"ZENIT&CO" SHPK	16,771,943.00	leke	279.00	pikë	Kualifikuar
10	"MOE" SHPK	16,836,048.00	leke	277.50	pikë	Kualifikuar
11	"C.E.C GROUP" SHPK	18,000,000.00	leke	271.50	pikë	Kualifikuar
12	BOE"ARENA MK SHPK & "HTSCOMPANY SHPK"	16,500,000.00	leke	216.00	pikë	Kualifikuar
13	TAULANT" SHPK	15,850,000.00	leke	0.00	pikë	Skualifikuar
14	BOE"ASH Engineering SHPK & HGH Engineering SHPK"	17,400,000.00	leke	0.00	pikë	Skualifikuar
15	"HYDRO-ENG CONSULTING" SHPK	16,589,640.00	leke	0.00	pikë	Skualifikuar
16	BOE"ANGERBA SHPK & LENI-ING SHPK"	17,319,891.00	leke	0.00	pikë	Kualifikuar
17	BOE"CIVIL CONSS SHPK & M.A.G PARTNERS SHPK"	15,670,000.00	leke	0.00	pikë	Skualifikuar
18	"M.A.K Studio" SHPK	17,760,000.00	leke	0.00	pikë	Skualifikuar
19	BOE"INFRA- PLAN SHPK & INFRATRANSPROJECT SHPK & SMS Consulting Engineering Structures Water and Survey SHPK"	16,160,000.00	leke	0.00	pikë	Skualifikuar
20	BOE"KLODIODA SHPK & SPHAERA SHPK"	16,340,000.00	leke	0.00	pikë	Skualifikuar
21	"S&L STUDIO" SHPK	16,140,000.00	leke	0.00	pikë	Skualifikuar

II.4. Në datën 03.12.2024, operatori ekonomik "M.A.K Studio" SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

"--Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "M.A.K. Studio" sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST, konkretisht;

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1. OE duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur e kontratës (vlera e fondit limit).

Puna e ngjashme, e paraqitur nga operatori ekonomik nuk e plotëson vlerën e kërkuar...".

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet, se në datën 12.12.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë "HYDROWATER-ALBANIA SHPK & STUDIO-REBUS SHPK", për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 18.12.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër

ankimi elektronik A/2024/4905, datë 18.12.2024, dhe me nr. 3681/2024 prot, datë 18.12.2024, e operatorit ekonomik “M.A.K Studio” SHPK, me anë të së cilës kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tij në këtë procedurë prokurimi, objekt ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3681/2, datë 19.12.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “M.A.K Studio” SHPK, për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tij në këtë procedurë prokurimi, në këtë procedurë prokurimi objekt ankimi.

II.8. Në datën 20.12.2024, në rrugë postare operatori ekonomik “M.A.K Studio” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik të njëjtën ankesë e cila është administruar pranë institucionit tonë me numër protokolli nr. 3681/3 prot, datë 20.12.2024.

II.9. Autoriteti kontraktor nëpërmejt sistemit të ankesave elektronike dërgoi në Komisionin e Prokurimit Publik vendimin “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga operatori ekonomik “M.A.K Studio” sh.p.k, me nr. Aplokimi: A/2024/4905 të paraqitur në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike” të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor, protokolluar me tonën me nr. 3681/4 prot datë 26.12.2024, ku informoi lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe vendimmarrja për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “M.A.K Studio” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“... IV. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës

Referuar pretendimit tuaj për plotësimin e kriterit në pikën 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate...,

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës mbas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana juaj për përmbushjen e këtij kriteri, arsyeton si më poshtë:

Operatori ekonomik “M.A.K Studio” në procedurën e prokurimit me objekt : “Supervizion punimesh Ndërtim aksi rrugor Elbasan - Papërr Faza II”, ka paraqitur si punë të ngjashme kontratën me nr. xx/xx/34, datë 08.10.2021 me objekt “Loti 3: Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor” të lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomik “M.A.K Studio & A & E Engineering” dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar me vlerë xxxx lekë pa Tvsh.

Sipas formularit të vlerësimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktor vlera e realizuar e punimeve është xxxx lekë me Tvsh ose xxxx lekë pa Tvsh.

Referuar përqindjes së bashkimit të operatorëve ekonomikë, shoqëria “M.A.K Studio” shpk., ka realizuar xx % të shërbimeve të kësaj kontrate.

Konkretisht vlera që i përkon shoqërisë “M.A.K Studio” shpk., është xxxx lekë pa Tvsh. Referuar kontratës së paraqitur me objekt: “Loti 3: Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor”, duam të sqarojmë që kontrata në fjalë është një kontratë shërbimi ku pjesa kryesore e shërbimeve të mirëmbajtjes rutinë prevalon mbi pjesën ndërtimore që i përket punimeve të rehabilitimit.

Në Specifikimet Teknike, pjesë e rëndësishme e Dokumentave të Tenderit janë të sqaruara shumë mirë ndarjet e shërbimeve me punimet ndërtimore në raportet rreth 60% (punime të mirëmbajtjes rutinë) dhe rreth 40% (punime ndërtimore/rehabilitimi).

Gjithashtu, në specifikimet teknike të kësaj kontrate citohet: “Në kontratat me Bazë Performancë, të cilat janë edhe subjekt i monitorimit nën këtë kontratë konsulence, kontraktori do të kryejë një numër aktivitesh (punë dhe shërbimi) me qëllim që të arrijë dhe mirëmbajtje nivelin e kërkuar të shërbimit për përdoruesit e rrugës në rrjetin rrugor që përfshin kontrata.”.

Në mënyrë specifike, punimet që do kryhen me kontratat e këtyre mirëmbajtjeve, janë:

- Punimet e Rehabilitimit të Rrugëve; punimet fillestare që kryhen gjatë 6 muajve të vitit të parë të kontratës me qëllim për të sjellë rrugën në standarte të paracaktuara. Këto punime i referohen të gjithë komponentëve të rrugës (drenazheve, punimeve të dheut, strukturave, shtresave asfaltike, elementëve të sinjalistikës, pajisjeve të sigurisë, vegjetacionit, e tjerë).*
- Mirëmbajtje Rutinë janë punime që kryhen rregullisht me qëllim që të mirëmbahen kushtet bazë dhe funksionaliteti i rrjetit. Këto aktivitete janë: riparimi i defekteve të shtresave, mirëmbajtja e bankinave, mirëmbajtja e drenazheve, mirëmbajtja e strukturave, mirëmbajtja e skarpave, mirëmbajtja e sinjalistikës dhe vijëzimeve, kontrolli i vegjetacionit, pastrimi i plehrave dhe vajrave në rrugë, përgjigjet ndaj incidenteve, si dhe punimet e mirëmbajtjes dimërore.*
- Punimet emergjente – janë aktivitete të nevojshme që duhet të kryhen për të risjellë rrugën në kushtet normale pas dëmtimeve të ndodhura përgjithësisht si rezultat i fenomeneve natyrore të paparashikuara.*

Punimet e mirëmbajtjes rutinë (sqaruar qartë edhe në specifikimet teknike) përfshijnë punime si: lëvizje e trafikut sipas një Plani të Aprovuar të Menaxhimit të Trafikut, riparimin e defekteve të rrugës (siç janë gropat, gjurmët e gomave të makinave, plasaritjet në shtresat e rrugës, anët e thyera), mirëmbajtja e bankinave, pastrimi i sistemeve të drenazhimit, mirëmbajtja dhe riparimi, pastrimi i rrugës dhe largimi mbeturinave, kontrolli i vegjetacionit, pastrimi dhe mirëmbajtja e shenjave rrugore dhe vijëzimi, shërbime të mirëmbajtjes dimërore etj.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk merr në konsideratë këto punime mirëmbajtje pasi nuk janë punime ndërtimore/rehabilitimi referuar objektit që prokurohet.

Objekti “Supervizion punimesh ndërtim aksi rrugor Elbasan - Papërr Faza II”, i referohet ndërtimit të një aksi rrugor Kategoria A, natyra e të cilit është komplet e ndryshme nga punimet e mirëmbajtjes së rrugëve.

Për sa më sipër, nga kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik “M.A.K Studio” me objekt: “Loti 3: Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor”, si punë e ngjashme për plotësimin e kriterit të pikës 2.3.1, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës për përmbushjen e këtij kriteri vlerëson vetëm punimet e rehabilitimit në vlerën rreth 40 %, që përkon me xxxx lekë pa tvsh. Kjo vlerë nuk e përmbush plotësimin e kriterit 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës (xxxx leke pa tvsh) së fondit të limit të kësaj kontrate..

IV. Vendimi i komisionit të shqyrtimit të ankesës:

1. Komisioni i shqyrtimit të ankesës vendosi të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “M.A.K” sh.p.k., për procedurën me objekt: “Supervizion punimesh Ndërtim aksi rrugor Elbasan - Papërr Faza II”, me fond limit: 18,230,373.81 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre presje tetëdhjetë e një) Lekë, pa TVSH Nr. REF-23013-10-07-2024.

2. Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ofertave t’i bëhet me dije Komisionit të Prokurimit Publik.”.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga ana e operatorëve ekonomikë të interesuar në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar .

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “M.A.K Studio” SHPK, mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “- Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “M.A.K. Studio” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht;
- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1. OE duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur

e kontratës (vlera e fondit limit). Puna e ngjashme, e paraqitur nga operatori ekonomik nuk e plotëson vlerën e kërkuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin e veçantë kualifikues, si më poshtë vijon:

“2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”.

III.1.2. Në Shtojcën 8 “FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar termat e referencës së shërbimit objekt-prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Në dokumentin e emërtuar “ToR Supervizion Ndertim Elbasan - Paper Faza II” të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), autoriteti kontraktor ndër të tjera ka përcaktuar llojin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

“II. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

“Ndërtim Elbasan -Papër”, Faza 2 ka një gjatësi 4 150 ml. Projektit fillon në progresivin 3+500, lidhet me Fazën 1 të po këtij segmenti rrugor dhe përfundon në progresivin 7+650 .

Aksi i rrugës, zhvillohet përgjatë bregut të Lumit Shkumbin.

Koordinata të përafërta sipas sistemit UTM 34N:

Fillimi $x = 416626$, $y = 4546860$,

Mbarimi $x = 413247$, $y = 4544696$.

Të dhënat gjeometrike:

Kategoria e rrugës, Kategoria A, (Autostradë Ndërrurbane Kryesore)

Korsi kalimi $2 \times 3,75\text{m}$ për çdo drejtim lëvizje

Trafikndarëse $2,6\text{m}$

Korsi emergjence $1 \times 3\text{m}$ për çdo drejtim lëvizje

Bankinë e asfaltuar $0,7\text{m}$ majtas, për çdo drejtim lëvizje

Bankinë e paasfaltuar $0,75\text{m}$ djathtas, për çdo drejtim lëvizje

Shpejtësia e projektimit 140 km/orë

Shpejtësia e lëvizjes 130 km/orë

Rrezja minimale në plan $1\ 000\text{ m}$

Pjerrësia maksimale $2\ \%$

Paketa e shtresave e parashikuar për rrugën kryesore është si më poshtë:

- Segmenti i Autostradës - kategoria A
- Shtresë veshëse(asfaltobeton): 4cm
- Shtresë lidhëse bituminoze(binder): 6cm
- Shtresë bazë bituminoze(konglomerat): 12cm
- Shtresë bazë (stabilizant): 20cm
- Nënshtrësë me material granular: 60cm

Rampat dhe rrugët dytësore

- Shtresë veshëse(asfalt i drenueshëm): 4cm
- Shtresë lidhëse bituminoze(binder): 5cm
- Shtresë bazë bituminoze(konglomerat): 10cm
- Shtresë bazë (stabilizant): 20cm
- Nënshtrësë me material granular: 30cm

Veprat e artit

Përsa i përket veprave të artit, duke qenë se gjurma e rrugës është e ndërtuar në një relief fushor, ka kryesisht, vepra të vogla arti si

- Tombino kuti, $[3 \times 3]\text{m}$, 5 copë (që shërbejnë edhe si nënkalime bujqësore)
- Tombino kuti, $[1,5 \times 1,5]\text{m}$, 2 copë
- Nënkalim, $[5 \times 3]\text{m}$, 1 copë

Gjithashtu, ky segment rrugor parashikon mure b/a, mure me dhe të armuar dhe në progresivën 7+000 me $L \sim 400\text{m}$, është realizuar mbrojtje lumore me mure gabion e

mbështetur mbi pilota.

Sinjalistika dhe Siguria Rrugore

Projekti ka të paraqitur planet e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, si dhe janë parashikuar elementët e sigurisë rrugore. Sinjalistika rrugore është përcaktuar mbi bazën e RrTPRr (vëllimi 6) si dhe në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa elementet e sigurisë rrugore janë në përputhje me politikat e rregulluara dhe miratuara për sigurinë rrugore që aplikohen në Shqipëri nga Qeveria Shqiptare.

Sistemi i linjave rezervë

Duke qenë se aksi është korridori kryesor që lidh lindjen me perëndimin e vendit tonë, në projekt janë parashikuar ndërtimi i linjave rezervë elektrike dhe për fibrat optike. Linjat rezervë do të vendosen nën bankinën e paasfaltuar të rrugës. Përgjatë linjave rezerve, në interval të përshtatshme dhe në kryqëzime apo intersektimet e rrugëve do të ndërtohen puseta kontrolli.”

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin elektronik, për përmbushjen e kriterit kualifikues të shtojcën 9 “Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, operatori ekonomik ofertues “M.A.K Studio” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

Marrveshje kuadër nr. xx/xx prot, datë 26.08.2021 të lidhur midis autoritetit kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “M.A.K Studio SHPK & A&E Engineering shpk”, me objekt; “Objekti i marrëveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe regullat për dorëzimin e mallrave/shërbimeve/punimeve në vijim në procedurën Marrëveshja Kuadër, I (një) Fitues për çdo lot /"Supervizion Mireëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Verior, Qëndror dhe Jugor" (ndarë në 3 Lote)", Loti 3: "Supervizion Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor" me fond limit xxxx (xxxx) leke pa tvsh, Me numër reference, Lotit I. REF-82944-12-23-2020.”, me vlerë të marrveshje kuadër xxxx leke pa TVSH dhe kohëzgjatje 48 (dyzet e tëtë) muaj.

Kontratë nr. xx/xx prot, datë 08.10.2021, të lidhur midis autoritetit kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “M.A.K Studio SHPK & A&E Engineering shpk”, me objekt: “Loti 3: Supervizion Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor”, me vlerë xxxx leke pa TVSH, dhe me afat realizimmi 24 (njëzet e katër) muaj (duke filluar menjëherë nga nënshkrimi i kontratës), ku vendodhja e shërbimeve që do të kryhen janë akset rrugore Rajoni Jugor Gjirokastër, si më poshtë:

- *Loti I: "Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga ura e Leklit - Këlcyrë - Përmet + rruga Valare - Erind - Çajup + rruga K/Dhuvjan - Libohovë 63.2 KM",*
- *Loti II: "Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Përmet - Çarshovë*

- + rruga Çarshovë - Tre Urat (doganë) + rruga Çarshovë - Leskovik 49.5 km",
- Loti II: "Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Korçë - Ersekë + rruga unaza Ersekë - Erscke + rruga K/Boboshticë - Dardhë 54,5 km"
 - Loti IV: "Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Korçë - Voskopojë + rruga Bilisht - Baban - Hoçisht + rruga ura Baban - qendra Baban 28.3 km",
 - Loti V: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Sarandë - Butrint + rruga Metoq - Çukë - Pllakë - Xarrë + rruga Çukë -kanali i Çukës 39.4 km"
 - Loti VI: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Muzinë - Delvinë + rruga Delvinë - Qafë Gjashtë + rruga ura Kardhiq - Prongji + rruga Vergo - K/Shijan + rruga Vergo - Prongji (loti 4+5+6) 59.1 km"
 - Loti VII: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Vlorë (k/spital) - Peshkëpi + rruga Peshkëpi - Selenicë + rruga Peshkëpi - Vllahinë + rruga Vllahinë - Poçem - Pavel + rruga Levan - Vlorë (e vjetra) 76,7 km",
 - Loti VII.: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Tepelene - Dukaj + rruga k/Salari - Sevaster + rruga Sevaster - Qafë Dushk + rruga Sevaster - Kalivaç + rruga Peshkëpi - Gjorm + rruga Bypass Tepelenë 84 km"
 - Loti IX: "Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Berat - Corogjaf + rruga Corogjaf - k/Gllavë - Antene + rruga Poshnje - Velemisht - k/Patos + rruga k/Marinëz- Marinëz, 70,2 km",
 - Loti X: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Berat - Çorovodë + rruga Çorovodë - Hambull + rruga Hambull - Rog 62,7 km"
 - Loti XI: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Cermë - hyrje Divjakë + rruga dalje Divjakë - plazh Divjakë + rruga jeta e re - Kosovë + rruga Bypass Fier - rrethrotullimi Kolonjë + rruga Fier - Seman plazh + rruga k/Pojan - Apolloni + rruga Bypass Fier 75,1 km".
 - Loti XII: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Patos - Ballsh + rruga Ballsh - Fratar + rruga Ballsh - Aranitas + rruga kr/rruga nacionale - Bylis + rruga mMetohasim-Kafaraj 61,4 km'.
 - Loti XIII: "Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Leskovik- Ersekë + rruga Leskovik – Tre Urat (doganë) 56.5 km".

Kontratë noteriale nr. xx rep, datë 08.11.2021, të lidhur midis operatorit ekonomik "M.A.K Studio" SHPK dhe operatorit ekonomik "A&E ENGINEERING" SHPK, ku qëllimi i kësaj

kontratë është si në vijim: “Qëllimi i kësaj kontrate, referuar kontratës noteriale te bashkepunimit Nr. xx Rep. dhe Nr. xx Kol.

është si më poshtë:

Përcaktimi i mënyrës së bashkërendimit, kordinimit midis dy shoqërive dhe ndarja e kompetencave, detyrave dhe përqindjes së realizimit të supervizionit mbas shpalljes fitues dhe nënshkrimit të kontratës me Autoritetin Kontraktor, për objektin si me poshtë:

Objekti: Loti 3: "Supervizion Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor"., ku shoqëria “M.A.K Studio” SHPK do të mbulojë xx % të vlerës së kontratës së supervizionit të punimeve të zbatimit dhe konkretisht do të jetë përgjegjëse për realizimin e shërbimit të supervizionit në lotet e akseve rrugore të projektit si më poshtë:

- Loti V: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Sarandë - Butrint + rruga Metoq - Çukë - Pllakë - Xarrë + rruga Çukë -kanali i Çukës 39.4 km"
- Loti VI: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Muzinë - Delvinë + rruga Delvinë - Qafë Gjashtë + rruga ura Kardhiq - Prongji + rruga Vergo - K/Shijan + rruga Vergo - Prongji (loti 4+5+6) 59.1 km"
- Loti IX: "Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Berat - Corogjaf + rruga Corogjaf - k/Gllavë - Antene + rruga Poshnje - Velemisht - k/Patos + rruga k/Marinëz- Marinëz, 70,2 km",
- Loti X: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Berat - Çorovodë + rruga Çorovodë - Hambull + rruga Hambull - Rog 62,7 km"
- Loti XI: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Cermë - hyrje Divjakë + rruga dalje Divjakë - plazh Divjakë + rruga jeta e re - Kosovë + rruga Bypass Fier - rrethrotullimi Kolonjë + rruga Fier - Seman plazh + rruga k/Poan - Apolloni + rruga Bypass Fier 75,1 km".
- Loti XII: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Patos - Ballsh + rruga Ballsh - Fratar + rruga Ballsh - Aranitas + rruga kr/rruga nacionale - Bylis + rruga mMetohasim-Kafaraj 61,4 km’.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 15.12.2021, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.1”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 31.12.2021, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.2”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 11.02.2022, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3

Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.3”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 15.03.2022, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.4”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 12.04.2022, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.5”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 15.05.2022, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.6”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 13.06.2022, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.7”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 13.07.2022, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.8”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 19.08.2022, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.9”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 14.09.2022, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.10”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 17.10.2022, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.11”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 15.11.2022, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.12”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 14.12.2022, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.13”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 31.12.2022, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3

Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.14”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 15.02.2023, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.15”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 17.03.2023, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.16”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 14.04.2023, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.17”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 18.05.2023, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.18”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 13.06.2023, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.19”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 18.07.2023, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.20”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 21.08.2023, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.21”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 20.09.2023, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.22”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Faturë tatimore elektronike nr. xx/xx, datë 23.10.2023, lëshuar nga shoqëria “M.A.K Studio” SHPK për autoritetin kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt: “Loti 3 Sup.Mirëmb.rruga Rajoni Jugor Sit nr.23”, me vlerë xxxx leke pa TVSH.

Formular vlerësimi lëshuar nga titullari i autoritetit kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar, ku vërtetohet se bashkimi i operatorëve ekonomik “M.A.K Studio SHPK & A&E ENGINEERING SHPK” (ku anëtari i këtij bashkimi “M.A.K Studio” SHPK ka realizuar 55% të shërbimeve) ka përmbushur në datën 08.10.2023, kontratën NR. xx/xx, datë 08.10.2021, me objekt: “Loti 3: Supervizion Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor”, në vlerën xxxx leke me TVSH.

Kontratë nr. xx prot, datë 25.01.2023, të lidhur midis autoritetit kontraktor Bashkia Përmet dhe shoqërisë “M.A.K Studio” SHPK, me objekt: “Për mbikqyrje punimesh në objektin ‘Sstemim asfaltim rruga Spital-Varreza’”, me vlerë xxxx leke pa TVSH. Me kohëzgjatje 6 (gjashtë) muaj.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.5. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4 ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.*
- 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme*

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.6. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”.

III.1.7. Në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (ndryshuar me VKM Nr. 710, datë 24.11.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”), përcaktohet se:

[...]

- 1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

2. *Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*
3. *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*
4. *Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*
5. *Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.*
6. *Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*
7. *Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën. [...].*

III.1.8. Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me

dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.9. Fillimisht KPP, gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të kërkesës kualifikuese lidhur me eksperiencën e mëparshme dhe të dokumentacionit provues që duhet të dorëzojnë operatorët ekonomikë ofertës.

Fillimisht, referuar dokumenteve të tenderit dhe konkretisht Seksionit 2 “*Objekti i kontratës*” dhe Seksionit 4 “*Procedura*” pika 4.1 “*Lloji i procedurës*”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt -ankimi, vërehet, se procedura e prokurimit objekt-prokurimi është procedurë prokurimi e hapur mbi kufirin e lartë monetar e llojit “*Shërbim*” dhe konkretisht autoritetit kontraktor kërkon që të realizojë blerjen e shërbimit të supervizimit të punimeve ndërtimore në aksin rrugor Elbasan - Paperr Faza II, për një afat shërbimi 24 (njëzet e katër) muaj.

Në dokumentet e tenderit të kësaj procedurë prokurimi dhe konkretisht në Shtojcën 9 “*Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” ” pika 2.3.1 “*Kapaciteti teknik*” të pikës 2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues lidhur me shërbimet e mëparshme të ngjashme, ku nga ana e entit prokurues është kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues për përmbushjen e këtij kriteri duhet që të kenë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, shërbime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më pak se **40 % të vlerës** së fondit të limit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pra operatorët ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë vërtetime që dëshmojnë realizimin e shërbimeve të ngjashme gjatë periudhës 3 (tre) vjeçare nga data e shpalljes së kësaj procedurë prokurimi dhe konkretisht data 08.10.2024 deri në datën 08.10.2021 dhe ku vlera e këtyre shërbimeve të ngjashme nuk duhet të jetë më pak se 40% e fondit limit të kësaj procedure prokurimi dhe konkretisht jo më pak se vlera 7.292.149,524 leke pa TVSH.

Për të vërtetuar se kanë realizuar shërbime të mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë pjesmarrës duhet që të dorëzojnë dëshmi për realizimin e këtyre shërbimeve, ku si dëshmi në rastin e realizimit të shërbimeve të mëparshme me ente publike kërkohen që të dorëzohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ndërsa si dëshmi në rastin e realizimit të shërbimeve të mëparshme me subjekte private, kërkohet që të paraqiten fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në Shtojcën 8 “*FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS*” të dokumentave të tenderit dhe konkretisht në dokumentin e emërtuar “*ToR Supervizion Nderim Elbasan - Paper Faza II*” të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin shërbimit objekt -prokurimi, duke përcaktuar shërbimin e supervizimit të punimeve ndërtimore të aksit rrugor Elbasan - Paperr Faza II, e cila është rrugë e kategorisë “A” që përfshin supervizim të punimeve ndërtimore si në vijim: “*Shtresë veshëse (asfaltobeton) 4cm, Shtresë lidhëse bituminoze (binder): 5cm dhe 6cm; Shtresë bazë*

bituminoze (konglomerat): 10cm dhe 12cm; Shtresë bazë (stabilizant): 20cm; Nënshtrësë me material granular: 30cm dhe 60cm; tombino kuti, [3 x 3] m, (që shërbejnë edhe si nënkalime bujqësore); Tombino kuti, [1,5 x 1,5] m, nënkalim, [5x3]m, mure b/a, mure me dhe të armuar dhe në progresivën 7+000 me L □ 400ml, është realizuar mbrojtje lumore me mure gabion e mbështetur mbi pilota.”.

Në rastin konkret, për sa kohë që kjo kontratë prokurimi klasifikohet si kontratë shërbimi, si dhe nisur nga fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se natyra e shërbimeve të ngjashme të realizuara nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues të cilët paraqesin ofertën e tyre për pjesëmarrje, që të kualifikohen, lidhur me kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 9 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, duhet që të paraqesin shërbime supervizimi të punimeve ndërtimore, i cili është edhe objekt i kësaj kontrate.

III.1.10. Për sa i përket arsyes së skualifikimit se: “--Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “M.A.K. Studio” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kritereve të kërkuara në DST , konkretisht;

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1. OE duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur e kontratës (vlera e fondit limit). Puna e ngjashme, e paraqitur nga operatori ekonomik nuk e plotëson vlerën e kërkuar...”, KPP nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konstaton, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 9 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumenteve të tenderit, ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme dhe konkretisht shërbime të supervizimit të punimeve ndërtimore, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pra shërbimet duhet të jenë të realizuara data 08.10.2024 deri në datën 08.10.2021 dhe ku vlera e këtyre shërbimeve të ngjashme nuk duhet të jetë më pak se 40% e fondit limit të kësaj procedure prokurimi dhe konkretisht jo më pak se vlera 7.292.149,524 leke pa TVSH, ku në rastin e realizimit të shërbimeve të mëparshme me ente publike kërkohen që të dorëzohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ndërsa si dëshmi në rastin e realizimit të shërbimeve të mëparshme me subjekte private, kërkohet që të paraqiten fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe dokumentacionit të ofertës, Komisioni konstaton, operatori ekonomik ankimues ka realizuar kontratën nr. xx/xx prot, datë 08.10.2021, të lidhur midis autoritetit kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “M.A.K Studio SHPK & A&E Engineering shpk”, me objekt: “Loti 3: Supervizion Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor”, me vlerë xxxx leke pa

TVSH, dhe me afat realizimmi 24 (njëzet e katër) muaj, ku refruar formularit të vlerësimit të lëshuar nga enti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar vërtetohet se ky operator ekonomik ka realizur xx% të vlerës së realizuar dhe konkretisht në vlerën xxxx leke pa TVSH, ku si dhe referuar Kontratës së bashkëpunimit nr. xx rep, datë 08.11.2021, ka realizuar shërbimin e supervizimit të shërbimeve si në vijim: “-Loti V: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Sarandë - Butrint + rruga Metoq - Çukë - Pllakë - Xarrë + rruga Çukë -kanali i Çukës 39.4 km"; - Loti VI: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Muzinë - Delvinë + rruga Delvinë - Qafë Gjashtë + rruga ura Kardhiq - Prongji + rruga Vergo - K/Shijan + rruga Vergo - Prongji (loti 4+5+6) 59.1 km"; - Loti IX: "Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Berat - Corogjaf + rruga Corogjaf - k/Gllavë - Antene + rruga Poshnje - Velemisht - k/Patos + rruga k/Marinëz- Marinëz, 70,2 km"; - Loti X: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Berat - Çorovodë + rruga Çorovodë - Hambull + rruga Hambull - Rog 62,7 km"; - Loti XI: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Cermë - hyrje Divjakë + rruga dalje Divjakë - plazh Divjakë + rruga jeta e re - Kosovë + rruga Bypass Fier - rrethrotullimi Kolonjë + rruga Fier - Seman plazh + rruga k/Pojan - Apolloni + rruga Bypass Fier 75,1 km" dhe - Loti XII: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Patos - Ballsh + rruga Ballsh - Fratar + rruga Ballsh - Aranitas + rruga kr/rruga nacionale - Bylis + rruga mMetohasim-Kafaraj 61,4 km’.”.

Lidhur me natyrën dhe vlerën e këtyre shërbimeve të realizuara nga ana e operatorit ekonomik ankimues “M.A.K Studio” SHPK në këtë kontratë, Komisioni konstaton se objekti i kësaj kontrate është shërbimi i supervizimit të mirëmbajtjes dimërore dhe rutinore të rrugëve (si më sipër përmendur), ku referuar arsyetimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës në vendimin e tij “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga operatori ekonomik “M.A.K Studio” sh.p.k, me nr. Aplokimi: A/2024/4905 të paraqitur në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike”, protokolluar me tonën me nr. 3681/4 prot datë 26.12.2024, i cili argumenton si në vijim: “Referuar kontratës së paraqitur me objekt: “Loti 3: Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor”, duam të sqarojmë që kontrata në fjalë është një kontratë shërbimi ku pjesa kryesore e shërbimeve të mirëmbajtjes rutinë prevalon mbi pjesën ndërtimore që i përket punimeve të rehabilitimit.

Në Specifikimet Teknike, pjesë e rëndësishme e Dokumentave të Tenderit janë të sqaruara shumë mirë ndarjet e shërbimeve me punimet ndërtimore në raportet rreth 60% (punime të mirëmbajtjes rutinë) dhe rreth 40% (punime ndërtimore/rehabilitimi).”, duke pranuar se kjo kontratë ka në objektin e saj dhe shërbimin e supervizimit të punimeve ndërtimore.

Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër, referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, konstatohet, se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka shqyrtuar nr. 96/34 prot, datë 08.10.2021, , të dorëzuar nga ankimuesi, pasi kjo kontratë është një kontratë shërbimi, e cila përfshin në objektin e saj dhe shërbimin e supervizimit të punimeve ndërtimore, pasi sipas argumentave të anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave kjo kontratë ka në objektin e saj dhe shërbimin e supervizimit të punimeve ndërtimore, duke krijuar indicie mbi përmbushjen e këtij kriteri. Me qëllim që këto indicie të shërbejnë si provë për përmbushjen e kriterit, KPP

gjykon, se autoriteti kontraktor para konstatimit të tij për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nisur nga fakti se kontrata objekt vlerësimi është e realizuar po me Autoriten Rrugor Shqiptar duhet të verifikojë vlerën e punimeve ndërtimore të realizuara në kontratën bazë me objekt: “-Loti V: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Sarandë - Butrint + rruga Metoq - Çukë - Pllakë - Xarrë + rruga Çukë -kanali i Çukës 39.4 km"; - Loti VI: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Muzinë - Delvinë + rruga Delvinë - Qafë Gjashtë + rruga ura Kardhiq - Prongji + rruga Vergo - K/Shijan + rruga Vergo - Prongji (loti 4+5+6) 59.1 km"; - Loti IX: "Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Berat - Corogjaf + rruga Corogjaf - k/Gllavë - Antene + rruga Poshnje - Velemisht - k/Patos + rruga k/Marinëz- Marinëz, 70,2 km"; - Loti X: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Berat - Çorovodë + rruga Çorovodë - Hambull + rruga Hambull - Rog 62,7 km"; - Loti XI: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Cermë - hyrje Divjakë + rruga dalje Divjakë - plazh Divjakë + rruga jeta e re - Kosovë + rruga Bypass Fier - rrethrotullimi Kolonjë + rruga Fier - Seman plazh + rruga k/Pojan - Apolloni + rruga Bypass Fier 75,1 km" dhe - Loti XII: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Patos - Ballsh + rruga Ballsh - Fratar + rruga Ballsh - Aranitas + rruga kr/rruga nacionale - Bylis + rruga mMetohasim-Kafaraj 61,4 km'." dhe të përcaktojë përqindjen e kësaj vlerë në raport me vlerën e përgjithshme të realizuar.

Referuar nenit 92 pika 1 të lex specialis në të cilin përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.”, autoriteti kontraktor për një shqyrtim të drejtë dhe objektiv të çështjes pa cenuar përmbajtjen e ofertës dhe duke mos pasur si qëllim ndikimin në vlefshmërinë e tyre, sa herë lind nevoja për sqarime mbi ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, ka detyrimin ligjor që në mbështetje të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, t’i drejtohet me kërkesë për sqarim operatorëve ekonomikë, në përmbushje të qëllimit të lex specialis të parashikuar në nenin 2 të tij.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “M.A.K Studio” SHPK qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “M.A.K Studio” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-23013-10-07-2024, me objekt “Supervizion punimesh Ndërtim aksi rrugor Elbasan - Paperr Faza II”, me fond limit 18,230,373.81 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre presje tetëdhjetë e një) leke pa TVSH ose 184,405.96 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesë presje nëntëdhjetë e gjashtë) euro pa TVSH, zhvilluar me datë 08.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “M.A.K Studio” SHPK, të korrigojë shkeljet e konstatuara, si dhe të kryejë veprimet procedurale në lidhje me zbatimin e konstatimeve të më sipërme.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “M.A.K Studio” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë..

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini
Kryetar		
Jonaid Myzyri		

